



LAJMËRIM

Mbi Regjistrimin dhe Kontrollin e Diplomave për Vitin Akademik 2019 – 2020 SEZONI I VERËS

Në kushtet e reja të krijuara nga pandemia “COVID-19” Rektori i UPT ka shpallur “Ndryshimet në Strukturën Mësimore për Vitin Akademik 2019-2020, Semestri i Dytë duke filluar nga data 30.03.2020 për Ciklin e Parë dhe Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve – Master i Shkencave dhe Master Profesional” të cilat përcaktojnë SEZONIN E MBROJTJES SË DIPLOMAVE DHE DHËNIES SË PROVIMIT TË FORMIMIT PËR TË GJITHË STUDENTËT QË DIPLOMOHEN NË VITIN AKADEMIK 2019-2020 – SEZONI I VERËS, NË PERIUdhËN 27.07 ÷ 07.08.2020.

Njoftohen studentët e Programit të Studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” për diplomat që administrohen nga Departamenti i Inxhinierisë që deri në **datën 20 QERSHOR 2020 të regjistrojnë¹ Temën e Diplomës dhe emrin e Udhëheqësit përkatës² pranë Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare.**

Studentët e mësipërm njoftohen se në mbështetje të Rregullores së FGJM dhe DIBM në **datën 30.06.2020, duke filluar nga ora 08:30** do të bëhet **KONTROLLI I PARË** i punës për përgatitjen e Temës së Diplomës. Studentët që kanë regjistruar brenda afatit Temat e Diplomës duhet të paraqesin pranë **Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare (zyra Dr. Jeton Pekmezi):**

1. Strukturën Paraprake të Temës së Diplomës;
2. Literaturën (titujt);
3. Materialet në versionin fillestar të tyre.

Studentët që kanë kaluar me sukses Kontrollin e Parë të Temës së Diplomës, në datën 15.07.2020, duke filluar nga ora 08:30 do të nënshtrohen KONTROLLIT TË DYTË të saj. Ata duhet të paraqesin pranë DIBM (zyra Dr. Jeton Pekmezi):

1. Strukturën Përfundimtare të Temës së Diplomës;
2. Literaturën e plotë;
3. Materialet e plota (mund të pranohen edhe në variantin bruto)³.

VETËM STUDENTËT QË KANË KALUAR ME SUKSES TË DY KONTROLLET E MËSIPËRM, KRAHAS DETYRIMEVE TË TJERA TË PARASHIKUARA NË AKTET LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI, DHE E KANË STRUKTURUAR SIPAS KËRKESAVE TË UDHËZIMIT TEMËN E DIPLOMËS, DO TË FITOJNË TË DREJTËN PËR TU FUTUR NË MBROJTJEN E SAJ, PËRPARA KOMISIONIT PËRKATËS.

¹Regjistrimi mund të bëhet edhe on-line në adresat: jpekmezi@gmail.com jeton.pekmezi@fgjm.edu.al

²Rekomandohet që udhëheqësi i propozuar të jetë Pedagog Efektiv/i Ftuar pranë UPT/FGJM/DIBM.

³Pas këtij kontrolli Studentit do ti mbetet vetëm hedhja në të pastër e materialit, printimi, dorëzimi i saj si edhe përgatitja e prezantimit.